

Statuti

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 07/ 02/ 2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **Cash Solutions Technology SH.P.K.**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- **Orest Gjoka**
- **Cash Solutions Technology shpk**
- **Rr. e Kavajes, pallati 2R shkalla 1 AP.12 kati 4**

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm (vetëm nëse është i përcaktuar):

1- Tregimi, prodhimi, mirembajtja dhe riparimi i aparaturave dhe aparatave kompjuterike dhe sistemeve te ngjashme dhe ofrimi i cdo sherbimi teknik per sisteme te tilla. Prodhimi, zhvillimi, aplikimi, perhapja dhe tregimi i programeve kompjuterike dhe grumbullimi e perpunimi i sistemeve software, informacionit te te dhenave qe lidhen me shkencen e informatikes. Te ushtroje veprimitari ne perpunimin kompjuterik te te dhenave dhe te dhenave te tjera per llogari te te treteve dhe te kontribuoje ne organizimin dhe funksionimin, ose me metoda teknike ose metoda te tjera e sistemeve te marres dhe dhenies se informacionit si dhe me tregimin e produkteve dhe sherbimeve te ngjashme me ato sa siper.

2- Te zhvilloje veprimitari per formimin dhe kualifikimin e personelit te shoqerive duke u ofruar specializim per te gjitha ceshtjet dhe ne te gjitha deget e shkences informatike dhe te organizoje e mbeshtese qendrat kompjuterike duke iu vene atyre ne dispozicion personel te specializuar dhe te ndermarrë studime per organizimin dhe zhvillimin e sherbimeve ne shoqeri, persona, korporata dhe ndermarrje tregtare. Te jape me qera pajisje (aparatura dhe software) qe ka lidhje ose eshte i nevojshem per sa me siper dhe te importoje dhe eksportoje produkte dhe sherbime te cilat kane lidhje me sa siper. Te kryeje cdo veprimitari tjeter te njejtë ose te ngjajshme qe kane lidhje me ceshtjet dhe qellimet e mesiperme.

3- Te prodhoje, tregtoje dhe ofroje mbeshtetje ne sisteme kompjuterike te komunikacionit dhe perpunimit te aplikimeve bankare dhe kreditore ose me sistemin e kartave te kreditit ose me mjete te tjera. Te merret me nxjerrjen dhe qarkullimin e revistes shkencore dhe botimeve te tjera qe kane lidhje me shkencen e informatikes dhe te zhvillimit te cdo veprimitarie me qellim nxitjen e kerkimeve ne sektorin e informatikes.

4- te zhvilloje tregti te pezgjitheshme dhe te bleje e rishesse mallra te cdo lloji qofte, produkteve dhe te mirave materiale, duke patur per qellim realizimin e fitimeve.

5- Te negocioje dhe te nenshkruej akt-marreveshje me prodhues dhe industrialiste dhe te bleje, furnizoje dhe magazinoje produkte, mallra dhe te mira materiale te cdo

Iloji. Te negocioje dhe te nenshkruaje rnarreveshje me tregtare dhe konsumatore per shitjen e mallrave dhe produkteve te edo Iloji. Te negocioje dhe te nenshkruaje marieveshje me pronare anijesh dhe transportues te cdo Iloji per transaportimin dhe levrimin e ngarkesave dhe te mallrave te cdo Iloji ne te cilat shoqeria mund te kete ose mund te mos kete interes.

6- Te zhvilloje veprimitari industriale dhe te krijoje, veje ne funksionim, administroje dhe te dtejtoje fabrika dhe qendrave artizanale per prodhimin ose perpunimin e mallrave dhe produkteve te cdo Iloji , ne cdo vend te huaj.

7- Te kontrakoje me shoqeri, ndermarrje, organizma, person, qeveri apo autoritet tjeter, per tu ofruar sherbim turisteve si dhe per zhvillimin e industrise turistike midis vendeve te huaja dhe te jape lehtesira dhe te veproje si keshilltar ose vizitor dhe pushues.

8- Te kryeje veprimitari ndermjetesimi dhe perfaqesimi dhe te ndermarre cdo Iloj veprimitarie si shkembim te furnizimit ose cdo shkembim tjeter lidhur me zhvillimin e tregtise nderkombetare ose nxitjen e importeve, te eksporteve, te turizmit, industrise dhe livrimin e mallrave ne cdo ane te botes.

9- Te zhvilloje cdo Iloj veprimitarie qe gjykohet e nevojshme per zhvillimin e tregtise te tranzitimit nderkombetar ose te importeve, eksporteve, ose qe konsiderohet prej saj frutdhenese ose me interes per shoqerine.

10-Te ndertoje, marre, zoteroje, te hape dhe te drejtoje hotele, apartamente te organizuar, kampe pushimi verore, restorante dhe qendra argetimi te cdo kategorie dhe te veje ne funksionirn, te drejtoje dhe te shfrytezoje ferma me objekt nxitjen e veprimitarive te shoqerise ose shtimin e fitimeve te shoqerise ose ofrim sherbimesh per pushuesit dhe udhetaret , vendas ose te huaj.

11- Te nenshkruaje akt-marreveshje dhe te bashkepunoje me shoqeri sigurimesh per sigurimin e automjeteve dhe mjeteteve te mekanizuara te cdo kategorie ndaj cdo reziku dhe per sigurimin e automjeteve, te jetes, nga zjarri, deti, te mallrave dhe te bagazheve te cdo kategorie, te cilat mund te konsiderohen te nevojshme per nxitjen e veprimitarive te shoqerise ose per tu sherbyer udhetareve dhe klienteve te shoqerise.

12- Te kryeje veprimitari transporti te udhetareve dhe te ngarkesave me makina shteterore ose private dhe te siguroje e te zoteroje Leje drejtimi automjetesh per cdo Iloj mjeti transporti dhe te nenshkruaje marreveshje dhe te bashkepunoje me shoqeri, persona dhe organima per zhvillimin dhe permiresimin e komunikacioneve si dhe per nxitjen ose shtimin e objekteve te shoqerise.

13- Te paraqese kerkesa dhe te marre, perdor , zoteroje dhe shfrytezoje cdo avantazh dhe te pranoje oferta si dhe te nenshkruaje marreveshje me persona, shoqeri ose organizma shteterore ose publike si dhe te ushtroje veprimitari te cdo Iloji qe ka lidhje me levizjen e udhetareve dhe te ngarkesave dhe zhvillimin e industrise ndertimore, te tregtise dhe te komunikacioneve si brenda ashtu dhe jashte vendit.

14- Te merret me komunikacione dhe te nenshkruaje marreveshje me zyra turistike, pronare anijesh , shoqeri ajrore, qeveri dhe organizma jashte vendit per permiresimin dhe zhvillimin e rrjetit te komunikacionit .

15- Te bleje, marre me qera toke, pasuri te patundeshme, ndertesa dhe magazina dhe ti rishese, jape me qera, te drejtoje dhe te shfrytezoje ferma dhe pasuri te patundeshme. Te ndaje token e lartpermendor se pasurine e patundeshme ne troje dhe te ndertoje mbi to shtepi, magazina dhe cdo Iloj godine tjeter dhe t'i rishese, jape qera, t'i drejtoje dhe t'i shfrytezoje ato me qellim qe te realizoje fitime. Te perfitoje te drejta pune dhe privilegje te cdo Iloji qe u sherbejne ose jane te perdonshem per pasurine e palujteshme te shoqerise.

16- Te importoje, eksportoje, bleje, shese dhe tregtoje mallra te ndryshme dhe te kryeje cdo Iloj tregtie me qellim rritjen e veprimitarise se saj dhe realizimin e fitimeve.

17- Te merret me industri, perpunimin, amballazhimin , prodhimin e produkteve industriale dhe buqesore ose plastike te cdo Iloji. Te merret me import-eksport dhe rishitjen e lendeve te para, instrumenteve, makinerive dhe pajisjeve dhe te objekteve

te ndryshme te cilet konsiderohen te nevojshem ose te perdorshem per industrine, ripunimin, amballazhimin dhe prodhimin e mallrave.

18- Te punesoje dhe pushoje nga puna nepunes, punetore, dhe te caktoje perfaqesues per kryerjen sa me te mire te veprimtarise se shoqerise.

19- Te depozitoje, angazhoje dhe te lere peng pasuri te lujteshme ose te palujteshme, ferma, mallra, te mira materiale, te drejta dhe lloj pasurie te shoqerise .

20- Te bleje, te marre me qera, te jape me qera, te posedoje ose perfitoje per qellimet e shoqerise prona, toke, ndertesa, te drejta, lehtesira ose privilegje te tjera mbi pronesine e palujteshme dhe te shese, te jape me qera ose te disponoje pasuri dhe te drejta te tilla. Te jape te drejta dhe cdo lehtesi mbi pasurine e patundeshme qe i perket shoqerise.

21- Te bleje ose perfitoje dhe te ruaje, rindertoje, pershtase dhe te mirembaje zyra, laboratore dhe objekte te tjere te cilet do te konsiderohen te nevojshem dhe te dobishem per objektin dhe veprimtarine e shoqertise.

22- Te paraqese kerkesa dhe te marre, bleje ose perfitoje projekte, shenja tregtare, shpikje, te drejta te pronesise intelektuale, metoda sekrete dhe privilegje te cdo lloji qe konsiderohen te dobishme per qellimet e shoqerise dhe tu jape leje dhe te drejta personave te trete per perdonimin e te drejtave dhe privilegjeve te tilla .

23- Te jape me qera, marre me qera dhe te disponoje krejt ose nje pjese te pasurise se lujteshme dhe te palujteshme te shoqerise ne perputhje me kushtet per te cilat vendos shoqeria.

24- Te nenshkruaje marreveshje me cdo qeveri ose autoritet ose organizem qofte shteteror ose vendor, te cilet mund te kontribuojn ne realizimin e qelliimeve te shoqerise ose te nje pjese te tyre dhe te siguroje nga keto qeveri, autoritetet ose organizma te drejta, privilegje dhe koncesione te cilat shoqeria i gjykon te nevojshme per ti siguruar dhe te zbatoje cdo marreveshje qe ka lidhje me dhenien shoqerise te te drejtave dhe privilegjeve .

25- Te leshej, pranoje, sigloje, shlyeje ceqe, kambiale, letra me vlera dhe tituj te tjere kreditues.

26- Te marre hua dhe per gjithesisht te gjeje para dhe vlera te tjera me emetimin e obligacioneve kredituese brenda dhe jashte vendit dhe te emetoje aksione favorizuese (PREFERENECE SHARES) me interes te caktuar dhe te pandryshueshem, me afat te caktuar ose jo te caktuar per sh1yerje, ceqe, hipotekime ose sigurime te tjera mbi krejt ose nje pjese te pasurise dhe te te drejtave te shoqerise, duke perfshire edhe te kapitalit te pa derdhur te shoqerise ose pa sigurime te tilla, por ne perputhje me kushtet qe kane lidhje me dhenien ose mos dhenien e perparese ose kushtete qe shoqeria do ti gjykoje me interes lidhur me qellimet dhe veprimtarine e shoqerise.

27- Te marre hua para deri ne shumen e kapitalit te miratuar aksionar te shoqerise ne perputhje me kushtet te cilat do te miratoje shoqeria dhe te garantoje detyrimet dhe kontratat e klienteve te shoqerise dhe per gjithesisht detyrimet dhe kontratat e personave te trete. Te marre hua para ose vetem ose se bashku me persona te tjere fizike oae juridike dhe te jape hipoteka, sigurime dhe garancita, lidhut me huate, detyrimet dhe per gjegjesite e personave fizike dhe juridike. Pergjithsisht, pa asnjë kufizim, tu jape ndihme ekonomike, tregtare dhe asistence personave qe kane te bejne me vete grupin e shoqerise ose qe kontrollohen nga vete aksionaret e shoqerise. Kredi dhe lehtesi qe kontraktohen prej shoqerise se bashku me persona te tjere fizike apo juridike, dhe kontrata huaje te kontraktuara me garanci te shoqerise mund te perdoren ose teresisht ose pjeserisht per realizimin e qelliimeve te shoqerise ose te personave te tjere qe i perkasin grupit te shqerise ose kontrollohen prej aksionereve te shoqerise.

28- Tu parapaguaje dhe tu jape hua para personave te trete nen garancine qe shoqeria do t'i konsideroje te pershtateshrne .

29- Te investoje parate e shoqerise qe nuk nevojiten eventualisht per perrnbushjen e qelliimeve te shoqerise ne ate menyre sic do te vendoset nga shoqeria .

30- Te regjistroje, bleje ose zoteroje , ose te pranoje, marre dhe te shese aksione dhe kapital, veprimtari dhe elemente pasurore te cdo shoqerie tjeter, organizate ose ndermarjeje tjeter, qellimet e se ciles ne teresi ose pjeserisht jane te ngjajshem me qellimet e shoquerise.

31- Te hape agjensi dhe perfaqesi vendore dhe ti rregulloje veprimtarite e ketyre agjensive dhe te perfaqesive ne ate menyre qe shoqeria e gjykon te pershtateshme.

32- Te marre masa per mireqenien e personave qe jane ne sherbim te shoqerise ose qe kane qene me pare ne sherbim te saj si dhe per mireqenien e bashkeshorteve, personave qe kane mbetur te ve, femijeve dhe familjeve te personave te tille. Te tilla privilegje mund te konsistojne ne dhenien e shumave monetare, pensione, dhurimeve mireberere ose pagesa te tjera dhe ne hapjen ose te kontribuoje ne hapjen e qendrave aresimore dhe qendrave te argetimit, te spitaleve dhe te farmacieve dhe ne dhenien e ndihmes mjekesore, ose te ndihmes qe shoqeria do ta konsideroje te pershtateshme. Privilegje te tilla mund te marrin formen e grantit, kontributit ose te ndihmes ndaj institucioneve filantropike, shkencore dhe mireberere.

33- Te paguaje kontribute ose kuota per qellime filantropike, bamiresie dhe te dobishme me karakter publik mbeshtetja e te cilave sipas gjykit te shoqerise mund te rrisin famen ose publicitetin shoqerise ne personelin e vet, tek klientet e shoqerise ose te publikut .

34- Te nenshkruaje dhe zbatoje marreveshje per zhvillimin e shoqerive joint-venture , te ndermarrjeve tregtare ose ne marrjen pjeze ne fitimet ose per bashkimin me shoqeri te tjera ose korporate ose person ose ndermarrje e cila ushtron veprimtari te ngjashme me ato te shoqerise. Parashikimet e paragrafit 27 do te kene zbatim te plete lidhur me kontratat e huase dhe garancite qe lidhen sebashku me shoqerine dhe me shoqerise qe hyn ne joint-venture me shoqerine.

35- Te themeloje shoqeri dhe ndermarrje me qellim qe te perfitoje ne te ardhmen element te aktivit dhe pasivit te nje shoqerie te tille ose me qellim qe te rrise veprimtarite e veta.

36- Te pranoje kapital ose aksione ose obligacione te garantuara me hipoteke ose vlera te tjera te cdo shoqerie qe synojne pagimin ose pagimin e pjesshem te sherbimeve te shoqerise ose shitjen ose shlyerjen e borxhit qe i detyrohet shoqerise shoqeria tjeter.

37- Tua shperndaje ne mall, sic do ta vendose shoqeria, elementin e aktivit te saj pjestareve te saj. Vecanerisht shoqeria mund tu ndaje aksione ose vlera te tjera te nje shoqerie tjeter e cila eshte kriuar me qellimin qe te perfitojen veprimtari ose elemente te aktivit ose pasivit nga shoqeria. Kjo gje mund te behet ne ate menyre qe shperndarja te mos konsiderohet si pakesim kapitali , pakesim i cili duhet te marre miratimin ne perputhje me ligjin ne kohen e shperndarjes.

38- Te zbatoje ne cdo ane te botes cdo veprim ose veprimtari qe lejohet nga ky akt themelimi vetem ose ne bashkepunim me shoqeri ose persona te tjere, ose si perfaquesues , administrator, agjent, te mirebesuar, ose nepermjet ajenteve, perfaquesuesve ose personave te mirebesuar.

39- Te zhvilloje veprimtari perfaqesimi tregtar, importimi, eksportimi dhe rishitje te mallrave te ndryshme qe kane lidhje me objektin e shoqerise .

40- Te zhvilloje veprimtari ne fushen e industrise dhe te artizanatit.

41- Te zhvilloje veprimtari sipermarrje , nenkontraktore ne fushen ndertimore.

42- Te zhvilloje cdo veprimtari tjeter qe ka lidhje me objektin e shoqerise dhe qe sipas gjykit te Keshillit Drejtues mund te zhvillohen. Per kete qellim shoqeria mund te themeloje ortakeri, ta regjistroje shoqerine dhe te bleje aksione dhe letra me vlere.

43- Te paguaje cdo shpenzim ose rendim qe ka te beje me zgjerimin dhe themelimin e shoqerise dhe te atyre shpenzimeve qe shoqeria do ti gjykoje si shpenzime fillestare duke perfshire edhe shpenzimet per reklamat, udhetimet jashte vendit, shpenzimet per gjetjen e kapitalit dhe burimeve financiare dhe per shpenzimet e materialit grafik dhe te shtypjes. Keto shpenzime duhet te miratohen nga Keshilli

Drejtues dhe te shlyhen brenda nje periudhe prej pese vjetesh nga data e themelimit te shoqerise.

44- Te bleje pjese ose krejt kapitalin aksionar te shoqerise, qellimet e se ciles perputhen pjeserisht ose teresisht me qellimet e kesaj shoquerie dhe te shese aksionet ose kapitalin e blere si dhe ta mbolle ate shoqeri.

45- Te reklamoje veprimtari, dyqane, objekte buqesore, ndermarrje dhe veprimtari te shoqerise qe ajo i gjykon te pershtateshme, duke perfshire dhe postimet e katalogeve te reklames qe kane lidhje me keto si dhe botimin e librave, fashikujve, katalogeve, fotografive dhe tablove ndricuese (SLIDES) dhe zhvillimit e konkurseve dhe ndarjen e cmimeve.

46- Te bleje ose perfitoje krejt ose nje pjese te ndermarrjes, te pasurise ose detyrime te cfaredo shoquerie, organizate, ortakerie ose personave qellimet e te cileve perputhen ose ne teresi ose pjeserisht me qellimet e shoquerise dhe ta likudoje dhe ta shperbeje nje nderrnarrje te tille.

47- Ne per gjithesi te kryeje cdo veprim qe ka lidhje ose sherben per perm bushjen me sukses te qellimeve te mesiperme. Deklarohet me anen e ketij akti se qellimet e shoquerise sic jane perkattuar ne nenparagrafet e mesiperme te ketij paragrafi do te perbejne qellime te vecanta dhe te percaktuara (DISTINCT) te shoquerise dhe nuk do te kufizohen nga ndonje nenparagraf ose dispozite qe permban te njejtat qellime ose me emertimin e shoquerise.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afate te papercaktuar, mbi 10 vjete.

**Neni 4:
Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rrugë e Kavajes, pall 2R, shkalla 1, Ap. 12 kat 4

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

CST-Albania@hotmail.com

**Kreu II
Kapitali**

**Neni 5
Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 lek Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Orest Gjoka : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 leke që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga

gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për keto kontributë sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organë Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngrijen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

(mbiemrat, emrat, adresat):

- **Orest Gjoka**

- **Ruga e Kavajes Pall 2R, Shkalla 1, Ap.12 kati 4** -

dhe specimenët e nënshkrimit:

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret Jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë regjistrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjesid;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i

asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV **Viti finanziar-ekspertet**

Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithhevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper ”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

O R T A K E T *E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR*

* Cash Solutions Technology SH.P.K *

Dresd Grloko
Emer mbiemer
(nenshkrimi) *JHFL*